



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

PROCESVERBAL

I pranimiit teknik te përkohshëm te punëve ne projektin “Asfaltimi i rrugëve Caravikë” Komuna e Klinës

Klinë: 26.09.2019

I përpiluar me datën, 26.09.2019 nga ana e komisionit për pranim teknik të punëve në projektin **“Asfaltimi i rrugëve Caravikë” Komuna e Klinës**

Komisioni është formuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me Vendim 06 nr351- 40611/19 të datës 25.09.2019 me këtë përbërje

1. Antonije Selmani
2. Ndue Sheraj
3. Dardan Bashota

Komisioni me përbërje të plotë ka filluar me punë më 26.09.2019 në ora 11, të pranishëm ishin edhe organi mbyqyres si dhe përfaqësuesi i punëkryesit.

Detyrë e komisionit për kontrolle teknik është shqyrtimi i dokumentacionit investivo teknik në bazë të së cilit është ndërtuar objekti dhe shikimi i punëve të kryera në vend.

Në bazë të shikimit të dokumentacionit investivo teknik komisioni ka konstatuar :

I Te dhënat e përgjithshme

- investitor është Komuna e Klines
- punekryes **“Agim Morina B.I “nga Malisheva**
- kontrata në mes të Komunës së Klinës dhe **“Agim Morina B.I.(NNT BURIMI) “nga Malisheva nr.61/2019 me numer protokoli 01nr.351-31738/19 e datës 26.07.2019 me vlerë të kontratës 38.010,08 €**
- Vendimi për menaxhimin e kontratës.
- Vendimi i komisionit për pranim teknik 06.nr.351-40611/19 e datës 25.09.2019
- Plani dinamik 50 ditë.
- Fillimi i punimeve sipas ditarit ndërtimor 26.08.2019.
- Perfundimi i punimeve sipas ditarit ndërtimor 23.09.2019

II Kontrolli i dokumentacionit teknik

- Skicat me paramasë dhe parallogari
- ditarin ndërtimor
- libri ndërtimor
- atestet e ngjeshmërisë për trupin e rrugës
- atestet e asfaltit
- fotografit të realizuara gjatë punimeve

III Kontrolli i punëve të kryera në vend

Pas shikimit të dokumentacionit investivo -teknik ,anëtarët e komisionit në praninë e përfaqësuesit të ekzekutimit të punimeve, menaxherit të projektit dhe organit mbikëqyrës bënë shikimin në vend me qëllim të kontrollit të kualitetit të punëve të kryera, veçanërisht në aspektin e plotësimit të kërkesave themelore për ndërtim dhe me këtë rast konstatoi:

- **“Asfaltimi i rrugëve Caravikë” Komuna e Klinës është ndërtuar sipas kontratës dhe parakushteve të ofruara nga projekti .**

Andaj pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko investiv që pati në dispozicion komisioni, dhe pas shikimit të punëve në vend, bazuar në konstatimet e lartcekura jep këtë

PERFUNDIM

“Asfaltimi i rrugëve Caravikë” Komuna e Klinës është ndërtuar në pajtim me rregullat e ndërtimit dhe dokumentacionin teknik. Gjatë ndërtimit janë aplikuar normativat dhe standardet e kërkuara për këtë lloji ndërtimi. Andaj behet pranimi teknik i përkohshëm për punët e kryera në projektin e cekur me lartë deri në kalimin e afatit garantues ku do të behet pranimi teknik përfundimtar.

Komisioni përfundoj me punë në ora 15,00h.


Menaxheri i projektit

Lorenc Marleku 

Organ mbikeqyres:

Dorentina Dushi 

Komisioni për pranim teknik:

1. Antonije Selmani 
2. Ndue Sheraj 
3. Dardan Bashota 